Shkolla është për fëmijën tënd

Një broshurë mbi planet e reja mësimore dhe mbi ligjin e ri arsimor, për ty që ke fëmijë në shkollë fillore (grundskola), në shkollë fillore të veçantë (grundsärskola), në shkollë speciale (specialskola) ose në shkollë same (sameskola)

Skolverket

Ti je me rëndësi

Ti je më i afërmi i fëmijës tënd. Prandaj është e rëndësishme që ti dhe shkolla e fëmijës tënd të keni lidhje të mira dhe të bashkëveproni rreth zhvillimit të fëmijës. Bashkëpunimi i shton mundësitë e fëmijës tënd që të arrijë sa më shumë, si në zhvillimin e diturive ashtu edhe në zhvillimin social.

Duke qenë i njoftuar me detyrën e shkollës ti i shton mundësitë e tua për bashkëpunim me shkollën e fëmijës tënd. Në këtë broshurë do të të jepen informata mbi disa ndryshime të cilat janë duke u bërë në shkollë e të cilat kanë ndikim te shkollimi i fëmijës tënd.

NOCIONET PRIND DHE KUJDESTAR LIGJOR

Zakonisht kujdestarë ligjorë të fëmijës janë prindërit e fëmijës, njëri ose të dy. Kujdestari ligjor ka përgjegjësi për fëmijën dhe duhet të kujdeset që fëmija të ketë përkujdesje, siguri dhe edukatë të mirë. Kujdestari ligjor i fëmijës ka thuajse gjithmonë të drejtë që t'i jepen të gjitha ato të dhëna të cilat kanë të bëjnë me fëmijën ose me nxënësin në shkollë, edhe të dhënat të cilat janë të mbrojtura me sekret zyrtar. Një prind i cili nuk është kujdestar ligjor i fëmijës nuk ka të drejtë që t'i jepen të dhënat e mbrojtura me sekret zyrtar.

Drejt cakut të njëjtë

Ligji arsimor dhe plani mësimor duhet të garantojnë që të gjithë nxënësit të kenë një shkollim të barasvlershëm të cilësisë së mirë, pa marrë parasysh se ku banojnë ose se në cilën shkollë a trajtë shkollore janë duke i vijuar mësimet. Ata caktojnë direktiva të punës që janë të njëjta për të gjitha shkollat. Riksdagu ka vënë një ligj të ri arsimor i cili vlen për tërë edukimin shkollor të fëmijëve dhe të rinjve në Suedi.

Në ligjin arsimor shkruan ndërmjet tjerash që të githë nxënësit duhet të marrin pjesë në edukim shkollor nëse nuk kanë arsye të vlefshme për mungesë. Si prind ti ke përgjegjësi që të kujdesesh që fëmija yt të jetë në shkollë. Nëse nuk ke lajmëruar mungesë, por fëmija yt përsëri mungon pa arsye të vlefshme, ti sipas ligjit arsimor duhet të informohesh për këtë nga ana e shkollës që atë ditë.

Nëse do të kërkosh pushim për fëmijën tënd atëherë duhet t'i drejtohesh drejtorit të shkollës. Drejtori i shkollës vendos në lidhje me pushimet. Drejtorit të shkollës duhet po ashtu t'i drejtohesh nëse dëshiron që të shqyrtohet se a ka mundësi që fëmija yt të lirohet nga ndonjë moment i obligueshëm në mësim. Mundësitë për lirim nga momente të tilla janë zvogëluar me ligjin e ri arsimor. Drejtori i shkollës ka mundësi ta miratojë këtë vetëm nëse ka arsye të jashtëzakonshme, dhe vetëm në lidhje me raste të rralla gjatë një viti shkollor, si dhe pa i kufizuar mundësitë e fëmijës që t'i arrijë kërkesat e diturisë. Megjithatë ti ke të drejtë të ankimosh një vendim të tillë te gjykata administrative (förvaltningsrätten).

Principali (komuna ose kryesia e shkollës së pavarur) e mban përgjegjësinë lokale për shkollën. Nëse dalin probleme të cilat nuk munden të zgjidhen nga ti dhe personeli ose udhëheqësia e shkollës, atëherë mundesh t'i drejtohesh principalit. Çdo principal duhet të ketë rutina me shkrim në lidhje me pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj edukimit shkollor. Mundesh t'i kërkosh këto te shkolla e fëmijës tënd.

Ligji i ri arsimor përmban disa dispozita të reja mbi ato që ka të drejtë të bëjë shkolla nëse ndonjë nxënës e prish rendin, ka sjellje të papërshtatshme ose nëse bën kundërvajtje më të rënda. Përveç mundësisë që nxënësi të largohet nga klasa deri në fund të orës së mësimit dhe të detyrohet të mbesë në shkollë pas orarit, drejtori i shkollës në disa raste mundet t'i japë nxënësit një paralajmërim me shkrim. Paralajmërimi duhet

të përmbajë informacion mbi atë që mundet të ndodhë nëse nxënësi nuk e ndryshon sjelljen e vet. Nxënësi mundet për shembull të vendoset përkohësisht në një shkollë tjetër.

Ligji i ri arsimor i jep po ashtu mundësi drejtorit të shkollës që të pezullojë nxënës nga shkolla fillore, shkolla speciale dhe shkolla same, nëse kjo është e nevojshme duke e marrë parasysh sigurinë dhe rehatinë studimore të nxënësve të tjerë dhe nëse masat e tjera kanë qenë pa rezultat. Pezullimi mundet të zgjasë më së shumti nga një javë çdo herë, dhe jo më shumë se dy herë gjatë një semestri. Nxënësi ka të drejtë që t'i kompensohet mësimi i humbur. Si kujdestar ligjor ti ke të drejtë ta ankimosh vendimin e drejtorit të shkollës mbi pezullim, te gjykata administrative.

Planet e reja mësimore

Duke u nisur nga ligji arsimor, plani mësimor për shkollën fillore, shkollën speciale, shkollën fillore të veçantë dhe shkollën same është rishkruar në atë mënyrë që secila trajtë shkollore të ketë një plan të vetin mësimor. Të gjitha shkollat, edhe ato komunale, edhe ato të pavarurat dhe shtetëroret, duhet t'i përmbahen planit mësimor për trajtën gjegjëse shkollore. Duke e lexuar planin mësimor ti mundesh të marrësh vesh se mbi çfarë themeli vlerash pushon shkolla dhe se çfarë detyrash dhe caqesh ka ajo. Në planin mësimor përfshihen gjithashtu planprogramet lëndore dhe kërkesat e diturisë për të gjitha lëndët.

Megjithatë, mënyra se si vendosin shkollat të punojnë mundet të ndryshojë. Këtë e caktojnë bashkë udhëheqësia dhe personeli i shkollës përkatëse. Edhe nxënësve duhet të u jepet mundësia që të bëjnë pjesë në këtë punë. Si prind ti mundesh të marrësh pjesë në këtë punë, nëpërmjet takimeve dhe bisedave të vlerësim-zhvillimit (utvecklingssamtal) në të cilat të ftojnë, po mundesh gjithashtu ta kontaktosh shkollën e fëmijës tënd për bashkëveprim në mënyra të tjera.

PLANI MËSIMOR

Në pjesën e parë të planit mësimor trajtohen themeli i vlerave të shkollës dhe detyrat e shkollës. Aty konstatohet që veprimtaria e shkollës duhet të jetë në përputhje me vlerat demokratike të shoqërisë dhe se të gjithë ata të cilët punojnë në shkollë duhet të kenë respekt për vlerën e çdo njeriu dhe për mjedisin tonë jetësor.

Në pjesën e dytë të planit mësimor gjenden caqet dhe direktivat e përgjithshme të edukimit shkollor. Aty caktohen normat, vlerat dhe dituritë të cilat duhet të jenë zhvilluar te të gjithë nxënësit pas përfundimit të shkollimit. Këto caqe duhet të zhvillohen nëpërmjet mësimdhënies në të gjitha lëndët shkollore. Dy pjesët e para të planit mësimor vlejnë po ashtu, me ndonjë përjashtim të vogël, mbi veprimtarinë në klasa parashkollore dhe në qendrat passhkollore për nxënës (fritidshem).

Në pjesën e tretë janë planprogramet lëndore me kërkesat përkatëse të diturisë për të gjitha lëndët.

PLANPROGRAMET LËNDORE DHE KËRKESAT E DITURISË

Në planprogramin e çdo lënde përshkruhet se për çfarë arsye lënda mësohet në shkollë, se cili është caku i mësimit dhe cilat dituri duhet që fëmija yt të ketë mundësi t'i zhvillojë. Në planprogramin lëndor caktohet po ashtu një përmbajtje qendrore. Përmbajtja e obligueshme është ajo që duhet të përfshihet në mësimet e lëndës përkatëse, por shkollat kanë gjithashtu mundësi që vetë të shtojnë përmbajtje të tjera.

Me kërkesat e diturisë plotësohet planprogrami lëndor. Kërkesat e diturisë shërbejnë për vlerësimin e zhvillimit të diturive të fëmijës tënd. Në to përshkruhet se çka duhet të dinë nxënësit në disa raste të caktuara dhe se si tregohet kjo. Në shkollën fillore

parashtrohen kërkesa për dituri të pranueshme në fund të klasës së tretë në lëndët suedishte, suedishte si gjuhë e dytë, matematikë, lëndët me orientim shoqëror dhe lëndët me orientim natyror. Në klasën e gjashtë parashtrohen kërkesa diturie në të gjitha lëndët përveç gjuhëve bashkëkohore dhe në klasën e nëntë parashtrohen kërkesa diturie në të gjitha lëndët.

Në klasën e tretë kërkesat e diturisë përdoren me qëllim që të bëhet vlerësimi se a ka dituri të pranueshme fëmija yt. Në klasën e gjashtë (që nga viti shkollor 2012/13) dhe në klasën e nëntë kërkesat e diturisë përdoren me qëllim që të vlerësohet se me cilën shkallë të notave përputhen dituritë e fëmijës tënd në lëndën aktuale. Kërkesat e diturisë janë të përpiluara duke u nisur nga një shkallë e re e notave dhe saktësohen në klasën e gjashtë dhe në klasën e nëntë për shkallat e notave E, C dhe A. Dituri të pranueshme do të thotë një nivel më i ulët i pranueshëm i diturisë, që po ashtu përputhet me notën E.

Në shkollën fillore të veçantë (grundsärskolan) parashtrohen kërkesa diturie në fundin e klasës së gjashtë dhe në fundin e klasës së nëntë për të gjitha lëndët. Në shkollën e trajnimit (träningsskolan) parashtrohen kërkesa për dituri themelore ose të thelluara në fundin e klasës së nëntë.

Në shkollën speciale (specialskolan), e cila është dhjetëvjeçare, parashtrohen kërkesa për dituri të pranueshme në fund të klasës së katërt në lëndët suedishte, suedishte si gjuhë e dytë, matematikë, gjuhë shenjash për të shurdhër dhe persona me dëgjim të dëmtuar, për lëndët me orientim shoqëror dhe lëndët me orientim natyror. Në klasën e shtatë parashtrohen kërkesa diturie në të gjitha lëndët përveç gjuhëve bashkëkohore dhe në klasën e nëntë parashtrohen kërkesa diturie në të gjitha lëndët.

Në shkollën same (sameskolan) zbatohen kërkesat e diturisë për shkolla fillore për klasat tre dhe gjashtë.

Më tej në këtë tekst, aty ku përmenden kërkesat e diturisë, informatat vlejnë vetëm për shkollën fillore. Për ty që ke fëmijë në shkollë fillore të veçantë, në shkollë speciale ose në shkollë same vlejnë informatat në këtë kuti.

Nëse do të lexosh më shumë mbi ligjin arsimor ose planin mësimor, këto i gjen te sajti i Entit Arsimor (Skolverket) **www.skolverket.se/skollagen2011 (ligji arsimor)** **www.skolverket.se/nyalaroplaner (plani mësimor)**

SHKALLA E RE E NOTAVE



Është futur në përdorim një shkallë e re e notave, me më tepër nota. Shkalla e re e notave përbëhet nga gjashtë nota: A, B, C, D, E dhe F. Nota A është nota më e lartë, ndërsa nota E është nota më e ulët për sukses të mjaftueshëm. Nota F është notë e pamjaftueshme. Nëse nxënësi ka patur aq shumë mungesa sa që mungon tërësisht baza për vënie note, kjo shënohet me një vizë.

Për shkollën fillore të veçantë shkalla e re e notave përbëhet nga pesë nota: A, B, C, D dhe E. Nota F ose shënjimi me vizë nuk ekzistojnë në këtë shkallë notash. Nëse një nxënës i shkollës fillore të veçantë nuk i plotëson kërkesat për notën E, ose nëse mungon baza për notë për shkak të mungesave, atëherë nuk jepet ndonjë notë në atë lëndë.

Për marrje të notave A, C ose E duhet të plotësohen tërësisht kërkesat përkatëse të diturisë. Për marrje të notës B duhet të plotësohet kërkesa e diturisë për notën C dhe pjesa kryesore e kërkesës së diturisë për notën A. Në të njëjtën mënyrë vlen që për marrje të notës D duhet të plotësohet tërësisht kërkesa e diturisë për notën E dhe pjesa kryesore e kërkesës së diturisë për notën C.

Nëse ti ose fëmija yt keni pyetje në lidhje me arsyet se pse është dhënë një notë e caktuar, ju sipas ligjit të ri arsimor keni të drejtë të informoheni për këtë gjë.

NOTA NGA KLASA E GJASHTË

Që nga vjeshta e vitit 2012 do të jepen nota nga klasa e gjashtë dhe paskëtaj për çdo semestër deri në notën përfundimtare në klasën e nëntë. Notat gjysmëvjetore do të vendosen në bazë të diturive të cilat i ka zhvilluar nxënësi deri më semestrin aktual. Vlerësimi në klasën e gjashtë do të bëhet në relacion me kërkesat e diturive për klasën e gjashtë. Që nga klasa e shtatë vlerësimi bëhet në relacion me kërkesat e diturive për klasën e nëntë.

Vlerësimi dhe bisedat e vlerësim-zhvillimit (utvecklingssamtal)

Për të qenë të sigurtë që zhvillimi i fëmijës tënd përputhet në drejtim me caqet e përgjithshme dhe synimet afatgjata të planit mësimor për çdo lëndë, është me rëndësi që puna e shkollës të zhvillohet në bashkëpunim me shtëpinë. Gjatë vitit shkollor mësuesi bën vlerësime të vazhdueshme të të mësuarit dhe zhvillimit të fëmijës tënd. Informatat për këtë të jepen ty, së paku një herë në semestër, kur ti dhe fëmija yt takoheni me mësuesin ose me kujdestarin e klasës për bisedë vlerësim-zhvillimi.

Në lidhje me bisedën e vlerësim-zhvillimit duhet të përpilohet një plan individual zhvillimi. Plani individual i zhvillimit duhet të përmbajë vlerësime të zhvillimit të diturive të fëmijës tënd në ato lëndë ku fëmija ka vijuar mësime. Plani duhet gjithashtu të përmbajë një përmbledhje të masave të cilat janë të nevojshme me qëllim që fëmija yt t'i arrijë caqet dhe të ketë zhvillim sa më të madh.

Nëse do të lexosh më shumë mbi bisedat e vlerësim-zhvillimit, planet individuale të zhvillimit me vlerësime me shkrim (IUP) dhe mbi programet e masave, ka informata te sajti i Entit Arsimor (Skolverket)
www.skolverket.se/iup

E drejta për zhvillim sa më të madh

Të gjithë nxënësve duhet të u jepet ai stimulim i cili u nevojitet gjatë të mësuarit dhe në zhvillimin e vet personal, me qëllim që të kenë zhvillim sa më të madh. Kjo vlen edhe për nxënësit të cilët i plotësojnë kërkesat e diturisë me lehtësi. Ata nxënës të cilët rrezikojnë që të mos i plotësojnë ato kërkesa të diturisë të cilat duhet të plotësohen së pakti, kanë të drejtë të kenë përkrahje të veçantë. Drejtori i shkollës e ka përgjegjësinë që të shqyrtohen nevojat e nxënësit për përkrahje. Nëse tregohet që nxënësi ka nevojë për përkrahje të veçantë, atëherë duhet të përpilohet një program masash.

Ti dhe fëmija yt keni të drejtë të merrni pjesë në përpilimin e programit të masave. Sipas ligjit arsimor ti po ashtu ke të drejtë ta ankimosh vendimin e drejtorit të shkollës mbi program masash, te Komiteti Ankimor për Arsim (Skolväsendets överklagandenämnd) Kjo vlen edhe për vendimet për mospërpilim ose påer mënyrën e përpilimit dhe për përmbajtjen e programit të masave. Ke gjithashtu të drejtë ankimimi nëse drejtori i shkollës vendos që përkrahja e veçantë të afrohet në një grup të veçantë mësimor ose nëse drejtori vendos për të ashtuquajtur edukim shkollor të përshtatur (anpassad studiegång).

Do ta lexosh tërë planin mësimor?

Plani mësimor mundet të porositet ose të merret nga sajti i Entit Arsimor www.skolverket.se

ISBN 978-91-86529-91-8
Grafisk form: AB Typoform
Omslagsfoto: Michael McLain
Foto inlaga: Michael McLain
Skolverket 2011

Skolverket